MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË NËSHOQËRINË ELBER SHPK, ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Shoqërinë "Elber" sh.p.k Elbasan, me objekt "Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomik dhe financiar" për periudhën 01.07.2010 deri 31.12.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 146 datë 30.09.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 734/10 datë 30.09.2012, dërguar Z.[redacted], Drejtor i Ujwsjellws Kanalizime, "Elber' Elbasan, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI .

Në zbatim të VKM Nr. 734, datë 01.11.2006 Për fillimin e procedurave për mbylljen e kontratës së koncesionit, për ndërmarrjen e Ujësjellës – kanalizimeve, Elbasan, dhe lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të blejë 100 përqind të aksioneve të shoqërisë "Berlinwasser International, GmbH" në "Elber" shpk, pika 5, ku në mënyrë eksplicite thuhet: Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme tekniko-juridike dhe të autorizimeve përkatëse për realizimin e procedurave.

Nisur nga fakti se megjithëse kanë kaluar 5 vjet nga dalja e vendimit, akoma nuk është ndërmarrë asnjë procedurë ligjore për ndryshimin e statusit juridik të shoqërisë "Elber" shpk, Elbasan, për të bërë të mundur zbatimin e VKM nr. 660, datë 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve të ujësjellësve dhe kanalizimeve, njësive të qeverisjes vendore" lidhja 1 nr. 41(Ujësjellës Qytet Elbasan, shpk).

Për sa trajtuam më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria Punëve Publike e Transportit për të ndërmarrë nismën ligjore për ndryshimin e emrit dhe statusit juridik të shoqërisë "Elber" shpk Elbasan nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare "Ujësjellës Kanalizime" sha, Elbasan, në zbatim Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

Brenda vitit 2012

B. MASA ORGANIZATIVE.

1. Të bëhet sistemimi në rubrikën e rezervave zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën 82.900.000 lekë, i evidentuar më datën 10.03.2008, në ekstraktin historik të regjistrit tregtar (QKR), deri në pritje të një vendimi nga asambleja e përgjithshme e ortakut të vetëm (METE).

Brenda vitit 2012

2. Në bashkëpunim me drejtuesit e pushtetit vendor, të transferohen aksionet e shoqërisë "Elber" sh.p.k., Elbasan në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konform VKM nr. 660, datë 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive ujësjellës kanalizime në Njësitë e Qeverisjes Vendore", ku

në pikën 41, të lidhjes 1, është parashikuar transferimi tek Bashkia Elbasan i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime, qytet shpk.

Brenda vitit 2012

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si pronar i vetëm i aksioneve të shoqërisë "Elber" shpk, të marrë në analizë sa më parë treguesit ekonomiko-financiar, planin e investimeve dhe shpenzimet e kryera nga shoqëria.

Menjëherë

4. Shoqëria "Elber" shpk, Elbasan të hartojë planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve të ujit për periudhën 2013-2015. Ky plan duhet të përmbajë objektiva dhe masa konkrete që duhet të ndërmerren nga shoqëria për eliminimin e humbjeve të ujit, i cili duhet të realizohet deri në fund të vitit 2015.

Brenda vitit 2012

5. Nga shoqëria "Elber" shpk, Elbasan për vitin 2012 të bëhet bilanci i ujit (analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxhariale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxhariale).

Menjëherë

6. Treguesit e prodhimit dhe të konsumit të energjisë elektrike të mbahen në mënyrë analitike për çdo pus uji dhe për çdo ditë. Gjithashtu, të vendosen matës për çdo pus, për të bërë të mundur matjen e prodhimit të ujit.

Vazhdimisht

7. Të analizohet gjendja e materialeve me qarkullim të ngadalshëm, materialeve të papërdorshme dhe materiale jashtë përdorimit, si dhe të merren masat e duhura konformë Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar".

Vazhdimisht

8. Për mjetet e transportit të hapen kartelat përkatëse, për të ngarkuar me përgjegjësi materiale personat që i përdorin.

Menjëherë

9. Për klorin, materialet e kancelarisë, detergjentët të zbatohen procedurat, konformë Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar".

Vazhdimisht

10. Pagat e personelit të mbahen brenda programit të kontabilitetit të informatizuar alpha.

Menjëherë

11. Kartelat e magazinës të pasqyrojnë njësinë fizike dhe vlerën e materialeve si dhe të bëhet rakordimi periodik ndërmjet magazinës dhe zyrës së financës.

Vazhdimisht

12. Kontabilitetit të mbahet sipas qendrave të kostos, veçmas për ujin dhe veçmas për kanalizimet, ndërsa mandatarkëtimet dhe mandatpagesat të jenë me numër serie.

Menjëherë

13. Shoqëria "Elber" shpk, Elbasan të hartojë dhe të miratojë një planbiznesi pesëvjeçar, ku të jenë pasqyruar tarifat e reja në 5-vitet e ardhshme. Mbi bazën e këtij planbiznesi duhet të zbatohen procedurat ligjore të miratimit të tarifave të reja të ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe të tarifave të tjera.

Brenda vitit 2012

14. Shoqëria "Elber" shpk, Elbasan të bëjë pajisjen e të gjithë klientëve me matës uji brenda vitit 2013.

Brenda vitit 2013.

15. Të merren masa për përmirësimin e faturës së ujit, duke futur dhe elementët shtesë, si: Tarifa e prerjes, tarifa e rilidhjes, tarifa e vulosjes së matësit dhe e penaliteteve të tjera.

Brenda vitit 2012

16. Të merren masa konkrete për evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve, duke koordinuar punën me sektorët përkatës. Për debitorët që nuk likuidojnë detyrimet përkatëse, të operohet në zbatim të Ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 "Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv".

Vazhdimisht

17. Shoqëria "Elber" shpk, Elbasan të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat si dhe të hartojë plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar".

Menjëherë

18. Në kuadrin e zbatueshmërisë të Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010, të bëhen kualifikime e seminare për zbërthimin e ligjit, mënyrën e analizës së Menaxhimit të riskut, për t'u njohur më mirë me konceptet e ligjit si dhe komponentët e MFK për të gjithë menaxheret e shoqërisë, më qëllim absorbimin dhe zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë.

Vazhdimisht

19. Të bëhen ndryshime në rregulloren e brendshme të shoqërisë nr. 1, datë 30.12.2011, ku të implementohen sistemet e kontrollit të brendshëm dhe treguesit e performancës, si dhe të bëhet miratimi i saj në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Brenda vitit 2012

20. Për të gjitha investimet e programuara në përmirësimin e rrjetit ekzistues, projektet duhet të shoqërohen me analizën e impaktit pozitiv, që do të sjellë kryerja e investimeve për çdo objekt në drejtim të uljes së humbjeve në rrjet, duke e ndjekur në vazhdimësi realizimin e këtyre objektivave.

Vazhdimisht

21. Autoriteti Kontraktor të likuidojë situacionet e kontraktuesve për punimet e kryera, në përputhje me afatet e kontratës, pasi moszbatimi i kontratës krijon risk për pagesa të tepërta nga ana e shoqërisë.

Vazhdimisht

22. Njësia e prokurimit, në hartimin e dokumenteve të tenderit, të përdorë formulime të sakta në kriteret e veçanta të kualifikimit, në përputhje me DST.

Vazhdimisht

23. Të merren masa për vendosjen e "taometrit" në makineritë e rënda si dhe të "aparatit të matjes së kilometrave" në të gjithë automjetet lëvizëse, për të bërë të mundur auditimin e zbatimit të normativave në drejtim të harxhimit të karburanteve.

Brenda 3 mujorit parë të vitit 2013

24. Të merren masa për rritjen e transparencës ndaj klientëve në lidhje me ankesat që kanë për mbifaturimet, verifikim të matësit të ujit, duke i trajtuar konform dispozitave ligjore për ankesat.

Vazhdimisht

25.Të kryhet inventarizimi fizik i aseteve të shoqërisë Elber shpk Elbasan , si dhe të aseteve të ish- ndërmarrjes së ujësjellësit Elbasan në vlerën 1.437.329.410 lekë, duke bërë përfshirjen e tyre në kontabilitet me miratim të METE-s, pasi bilanci nuk pasqyron realisht pasurinë e shoqërisë Elber shpk, Elbasan.

Brenda vitit 2012

26. Të hartohet regjistri i aktiveve afatgjatë dhe afatshkurtër si dhe të bëhet grupimi përkatës brenda llojit, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar"

Menjëherë

27. Të bëhet ndarja e detyrave dhe përgjegjësive për punonjësit e kësaj shoqërie, në zbatim të Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar".

Menjëherë

28. Të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të Auditit të METE-s dërguar me shkresën nr.786/7, datë 18.01.2012.

Gjatë vitit 2012

29. Të bëhet identifikimi i të gjithë abonentëve familjarë, privatë, institucioneve buxhetore, jobuxhetore etj, duke përcaktuar vendndodhjen e tyre sipas zonave ku gjenden, me synim të pajisjes së tyre me kontrata furnizimi me ujë, të cilat të hidhen në hartën përkatëse.

Menjëherë

30. Të merren masa për përmirësimin e treguesve të performancës për raportet: Prodhim-faturim, faturim-arkëtim, për të realizuar përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë dhe uljen e humbjeve në rrjet.

Vazhdimisht

31. Në treguesit e performancës të Elber shpk, Elbasan për çdo sektor, Degë duhet të përfshihen edhe ankesat e qytetarëve, nëpërmjet caktimit të kufirit minimal të lejuar për numrin e ankesave mujore të qytetarëve, në lidhje me:
- Respektimin e orareve të furnizimit me ujë për çdo zonë të Qytetit të Elbasanit, të caktuar nga Elber shpk dhe të publikuar në faqen e internetit të shoqërisë.
-Për mbifaturimet, për faturimet afrofe, për mosvendosje të matësve të ujit, për faturim të subjekteve private si familjarë, për furnizim me ujë pa lidhur kontratë me ujësjellësin, për lidhje të paligjshme, për shpërdorim të ujit pijshëm etj, tejkalimi i të cilave vlerësohet si mosrealizim treguesish.

Menjëherë

32. Të bëhet vlerësimi i stafit drejtues për çdo Degë, Zyrë , Sektorë dhe Njësi, në përputhje me realizimin e objektivave të programuar për çdo vit, duke bërë ndryshimin e stafeve drejtuese për çdo pozicion pune që paraqitet me mosrealizime të treguesve të programuar.

Vazhdimisht

33. Në prokurimin e fondeve të zhvillohen procedurat e prokurimit "Tender i hapur" dhe në rastet e përdorimit të procedurave të tjera, kryesisht "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit", të bëhet një argumentim rigoroz për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.

Vazhdimisht

C. MASA ZHDEMTIMI

Të ndiqet zbatimi i masave të zhdëmtimit të rekomanduara nga KLSH me shkresën nr. 292/11, datë 13.10.2009

1. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën prej **19 768.5 Euro,** si diferencë të punimeve të realizuara në krahasim me volumet e përshkruara në situacionin përfundimtar nga firma [redacted]

Menjëherë

2. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën prej **42 214 Euro,** si penalitet për mospërfundim në afat të punimeve nga firma [redacted]".

Menjëherë

3. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën prej **18 900 Euro,** si pagesa të pamotivuara, nga firma konsulente "[redacted]".

Menjëherë

4.Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit prej **60 700 Euro**, për pagesa të pamotivuara në favor të Konsulentit "[redacted]".

Menjëherë

5. Të zhdëmtohen nga ish-drejtori i Përgjithshëm [redacted] shpenzimet për telefonin celulare për vitin 2010 në vlerën 700.052 lekë përfituar më tepër, në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.07.2002 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë", i ndryshuar**.**

Brenda vitit 2012

6. Të zhdëmtohet nga ish-drejtori i përgjithshëm [redacted] shuma 24.000 euro, kryer transfertë si parapagim për periudhën janar-qershor 2011, në favor "[redacted]", bazuar në Marrëveshjen e Delegimit, e cila nuk ishte e depozituar në shoqërinë "Elber" shpk dhe nuk është e autorizuar nga METE për nënshkrimin e kësaj marrëveshje.

7. Të kthehet nga ish-drejtori i Përgjithshëm z. [redacted] shuma 3631 euro, tërhequr paradhënie për vitin 2010, e cila rezulton e pa kthyer në vitin 2011.

Brenda vitit 2012

8. Të zhdëmtohet nga ish-drejtori i përgjithshëm [redacted] shuma 93.500 lekë. shpenzim për blerje Krem Aroma" e "Kafe", nga Subjekti [redacted] shpk të artikullit Krem Aroma" e "Kafe", pasi mbulimi i këtij shpenzimi nga ana e shoqërisë, në favor të Drejtorit të saj, bie në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar.

Brenda vitit 2012

Ç. <u>MASA DISIPLINORE</u>

Për periudhën e audituar vitin 2011, nuk u konstatuan shkelje të karakterit që mund të jepen masa disiplinore, pasi shoqëria ka reaguar për të eliminuar shkeljet e konstatuara nga Auditimi i METE-s për vitet 2009-2010 të shoqëruara me dëme ekonomike nga keqmenaxhimi i shoqërisë nga ish-drejtori i përgjithshëm Atila Gjuladin i cili nuk ka zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Shënim.
Për ish- punonjësit e mëposhtëm:
1. Z. [redacted] me detyrë ish- drejtor i Përgjithshëm (nënshtetas i huaj) për periudhën 01.02.2004- 15.12.2010.
2. Z. [redacted] me detyrë ish-kryeinxhinier për periudhën 10.07.2004-23.11.2011.
3. Z. [redacted] me detyrë ish-shef i Zyrës së Financës për periudhën 18.04.2002-30.04.012.
4. Zj. [redacted] me detyrë ish-llogaritare e parë për periudhën 01.04.2007-18.05.2012.
5. Zj. [redacted] me detyrë ish-juriste për periudhën 01.08.2003-26.03.2012.
Për ish-anëtarët e Njësisë Prokurimit:
1. Z. [redacted].
2. Z. [redacted].
3. Z. [redacted] Specialist i jashtëm (Jurist).
Nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre.
Ngarkohet Elber shpk, Elbasan që për ish- punonjësit e mësipërm të larguar nga puna të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH-së.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Rustem Tare, Nefail Xhepexhiu**,** Fatmir Iljazi**,** më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Erjon Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT